

# PROÇESI I TRAJNIMIT

## 1 NEVOJAT PER ANALIZE

Kjo fazë e parë eksploruese e kërkesës dhe nevojave të tregut të punës, konsiston në mbledhjen e informacionit me anë të vëzhgimit në terren dhe intervistave individuale ose grimore me anëtarët e organizatave. Rezultati i analizës është sistemimi i objektivave të përgjithshme që do të ketë kursi i trajnimit.

**Mjetet që mund të përdorni janë: ESCO, EQAVET**

## 2 DEZINJIMI

Faza e dizajnimit të trajnimit, përfaqëson thelbin e projektit të trajnimit dhe, përbëhet nga disa faza dhe elementë: - përcaktimi i objektivave të të nxënit (njohuritë, aftësitë dhe kompetencat), - Zgjedhja e aktiviteteve trajnuese që do të përfshihen në veprim; - zhvillimi i strategjive dhe mjeteve të monitorimit, vlerësimi dhe mjetet dhe strategjitë e vlerësimit.

**Mjetet që mund të përdoren janë: Rezultatet e të nxënit, ESCO, Europass**

## 3 ZBATIMI

Përfaqëson momentin e zbatimit të veprimtarisë; në këtë fazë është e mundur të vëzhgohet dhe vlerësohet ecuria e asaj që u zbulua në fazën e identifikimit të nevojave për trajnim, dhe e asaj që u vendos në fazën e planifikimit, e në mënyrë indirekte, për të vlerësuar efektivitetin e saj.

**Mjetet që mund të përdorni janë: EQAVET dhe ESCO**

## 4 VLERËSIMI

Vlerësimi i rezultateve nuk është një proces që zhvillohet vetëm në fund të të gjithë ciklit të trajnimit për të verifikuar arritjen e objektivave mësimore, por bëhet para, gjatë dhe pas realizimit të një projekti. Prandaj, është thelbësore të identifikohen një sërë treguesish vlerësimi në lidhje me objektivat, dhe e mbi të gjitha ato që lidhen me të gjitha fazat e ndryshme të projektit.

**Mjeti që mund të përdoret është: EQAVET**

## 5 RISHIKIM

Rishikimi i rezultateve të trajnimit të ofruar për të analizuar me kujdes performancën e arritur dhe mësimet e nxëna, në mënyrë që ato, të jenë të dobishme për projektet e ardhshme.

**Mjetet që mund të përdoren janë: EQAVET, ESCO, Rezultatet e të nxënit**



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

# FUNKSIONALITETE T E MJETEVE



## ANALIZA E NEVOJAVE

Në këtë fazë ju mund të përdorni ESCO për të hulumtuar profilin profesional për të cilin jeni të interesuar, zëvendësuesit që përdoren në tregun evropian të punës për të përcaktuar të njëjtin profesion, profilet, si dhe grupe të aftësive dhe njohurive të nevojshme ose shtesë që në figurë duhet të zotërojë.

Nëse është e dobishme, do të jeni në gjendje të analizoni vetëm kompetencat dhe aftësitë pa u fokusuar në figurë. Kjo do t'ju lejojë të përcaktoni një analizë me një gjuhë që mund të kuptohet nga të gjitha ndërmarrjet evropiane dhe që është lehtësisht e transferueshme në kontekste të huaja, duke përfshirë kontekste jo të BE-së. Duke aplikuar EQAVET, ju mund të konsultoheni me palët e interesuara publike dhe private, për mbështetje në analizën tuaj.



## DIZAJNIM

Në këtë fazë, rezultatet e të nxënimit do t'ju ndihmojnë të përcaktoni rezultatet e arritura në fund të ndërhyrjes së trajnimit dhe t'i ndani ato menjëherë me nxënësit. Duke vepruar kështu, çdo person i përfshirë në procesin e trajnimit do të jetë i vetëdijshëm për qëllimin e tij dhe do të jetë në gjendje të bëjë zgjedhje.

ESCO do t'ju ndihmojë në identifikimin dhe zvogëlimin e objektivave të kompetencave dhe aftësive të rrugetimit me një vëmendje të veçantë edhe ndaj kompetencave transversale më të kërkuara në nivel të BE-së, si kompetencat e gjelbra dhe dixhitale. Konsultimi i Portalit Europass do t'ju japë një pamje më të saktë të aftësive të kërkuara nga sektorët e tregut, duke përfshirë edhe ata më inovativët.



## ZBATIMI

Në këtë fazë, EQAVET dhe ESCO ju lejojnë të ofroni trajnime në një mënyrë funksionale dhe efektive, duke mbajtur gjithmonë nën kontroll rezultatet e planifikuara të mësimit dhe duke i riorganizuar ato në itiner, nëse lind nevoja për të bërë ndryshime në program për shkak të niveleve të kompetencës së pragut që nuk janë arritur ose tejkaluar shumë përpara asaj që ishte planifikuar. Në të njëjtën kohë, të dy mjetet mund të përdoren në përcaktimin e mjeteve të monitorimit për ekipin e mësimdhënies dhe menaxhimit.



## VLERËSIMI

EQAVET ofron një repertor të pasur treguesish vlerësimi që janë shumë të dobishëm si për vlerësimin e vazhdueshëm ashtu edhe për atë përfundimtar të kursit të trajnimit. Në fund të fundit, vetëm me një vlerësim të vazhdueshëm dhe tërthor të të gjithë procesit të trajnimit, përdoruesit dhe stafi i ofrimit do të jenë në gjendje të vlerësojnë rezultatet e arritura dhe të ndërgjegjësohen për pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve, ekipeve të punës, strukturës së përgjithshme të kursit dhe shumë më tepër...



## RISHIKIM

EQAVET, ESCO dhe Rezultatet e të nxënimit do të jenë më të dobishme në këtë fazë, pasi të përfundojë faza e vlerësimit, do të jetë e mundur të nxirren konkluzione përfundimtare, të rishikohet propozimi i paraqitur për trajnim në dritën e ripërshtatjes së figurës profesionale, kompetencave, aftësive, dhe të përshtaten rezultatet e të nxënimit me synim, realizimin e ardhshëm të iniciativës ose për informacionin e stafit teknik të organizatës.